



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 417/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Lëvizjes Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 12.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR).

Lëvizjes Vetëvendosje, i shqiptohet dënimi më gjohë në vlerë prej 1550 (njemijepesqindpesdhjet) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Më datë 10.12.2010 PZAP ka pranuar një ankesë nga AKR, në të cilën pretendohet se kandidatja e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, konkretisht Igballe Malushaj, me date 09.12.2010 në rrugën Bajram Kelmendi në Prishtinë ka mbuluar me posterat e saj, posterat e kandidatit për deputet nga Koalicioni për Kosovën e Re Shaip Vitia, duke shkelur në këte menyre nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi, në të cilën shihet qartë se posterat e kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje Igballe Malushaj, është i vendosur mbi posterat e kandidatit të Koalicionit për Kosovën e Re. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi Lëvizjen Vetëvendosje, më datë 11.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 12.12.2010, deri në orën 12:00. PZAP-i nuk mori përgjigje në ankesë nga Lëvizja Vetëvendosje, sipas afatit të caktuar.

Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërës si në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posterit ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

-ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se posterit i kandidatit për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës, nga radhët e LV, është vendosur mbi posterin e kandidatit nga Koalicioni Kosova e Re. Gjithashtu, PZAP-i vlerëson se Lëvizja Vetëvendosje, shkeljet e kësaj natyre ka përsëritur edhe më parë, rrjedhimisht konsiderohet si recidivist, rrethanë e cila ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar me gjobë. Prandaj për këto arsye dhe më qëllim të evitimit të shkeljes së lartcekur si dhe në pajtim me

dispozitat e lart cekura ligjore, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 417/2010 më datën 12.12.2010

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

